Vendim nr. 307, datë 28.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 28.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (F) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FRAN DASHI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 862, datë 21.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 30-2023-3699, datë 06.07.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2026-238, datë 26.02.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, si dhe 141, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 06.05.2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (*Prokuroria Elbasan*) është regjistruar kallëzimi penal i paraqitur nga kërkuesi, kundër shtetasit B.H., me funksion ish-drejtues i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për kryerjen e veprave penale "Fshehja e pronësisë", "Shpërdorimi i detyrës", "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim" të parashikuara nga nenet 143/a/6, 248 dhe 257/a të Kodit Penal. Si fakte dhe prova për dyshimet se shtetasi B.H. ka kryer veprat penale të mësipërme, kallëzuesi i referohet arsyetimit të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra.

2. Me vendimin, datë 09.05.2022, Prokuroria Elbasan ka vendosur mosfillimin e procedimit penal duke arsyetuar se në rastin konkret nuk evidentohet plotësimi i elementeve të figurave të veprave penale të kallëzuara, cenimi i marrëdhënieve juridike të posaçme, si dhe konsumimi i veprimeve ose i mosveprimeve, me qëllim kriminal në veprimet e shtetasit të kallëzuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, duke pretenduar se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë pa u kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm dhe nuk është i mbështetur në ligj.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 862, datë 21.11.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, duke vlerësuar se vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është në përputhje me ligjin material e procedural. Sipas gjykatës së shkallës së parë, në rastin objekt shqyrtimi, nuk plotësohen kushtet për fillimin e një procedimi penal, në bazë të neneve 290, pika 1, shkronja "ç", dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

4. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 30-2023-3699, datë 06.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndër të tjera ajo gjykatë ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të dispozitave procedurale penale për mosfillimin e procedimit penal. Në rastin konkret, nuk është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore, si edhe nga ana e fakteve çështja është zgjidhur drejt nga ana e organit të akuzës. Sipas gjykatës së apelit, hetimi i kryer nga trupat gjykues në funksion të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 84/2016*), është një hetim administrativ dhe moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit, nuk mund të përkthehet në përgjegjësi penale të subjektit të rivlerësimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuesi ka ushtruar rekurs.

5. Me vendimin nr. 00-2026-238, datë 26.02.2026, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, të cilat konsistojnë në interpretimin ose zbatimin e ligjit me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, shkeljen e ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, dhe as nuk evidentojnë se vendimi i ankimuar bie në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 16.06.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore, sipas objektit. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës për hetim efektiv*, pasi Prokuroria e Elbasanit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në funksion të kallëzimit penal, si dhe nuk ka administruar të gjitha praktikat e KPA-së, Komisionerit Publik, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar për subjektin e kallëzuar B.H.

7.1.2. *Së drejtës për gjykim të drejtë*, pasi vendimi i prokurorit, datë 09.05.2022, për mosfillimin e procedimit penal, është marrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 290 të KPP-së dhe tej afatit ligjor 15-ditor të parashikuar nga neni 291 i këtij kodi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

8. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje

Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial *(shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor që ka vendosur për rrëzimin e ankimit të tij ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e paraqitur nga ai (kërkuesi). Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

10. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur për mosfillimin e procedimit penal, duke kundërshtuar, në thelb, mosndjekjen penale të personit të kallëzuar prej tij, shtetasit B.H., me funksion ish-drejtues i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për vepra penale që ndiqen kryesisht, ndonëse ai nuk është i dëmtuar ose viktimë e drejtpërdrejtë e atyre veprave penale. Në lidhje me këtë, gjykatat e zakonshme kanë arritur në përfundimin se në rastin objekt shqyrtimi, nuk plotësohen kushtet për fillimin e një procedimi penal, në bazë të neneve 290, pika 1, shkronja "ç", dhe 291 të KPP-së.

12. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimet në themel të kërkuesit nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndonjë të drejtë të tij kushtetuese substanciale. Nga ana tjetër, Kushtetuta

dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk garantojnë të drejtën për të filluar ndjekje penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre *(shih Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.09.2006).*

13. Për sa më lart, vlerësohet se vetëm fakti i paraqitjes së kallëzimit penal nga kërkuesi nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e tij në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

14. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.